VENDIM
Nr. 37, datë 1.2.2013

PËR ZGJERIM ZONE LICENCIMI PËR RADION VENDORE PRIVATE
"RADIO DURRËSI"
SUBJEKTIT: "RADIO DURRËSI" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor", miratuar me vendimin nr. 355 pika 2, datë 29.8.2005 rregullores "Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor", miratuar me vendimin nr. 355 pika 1, datë 29.8.2005, rregullores "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizvë", miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimit nr. 161, datë 30.11.2012 "Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë", pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit, dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit "Radio Durrësi" sh.p.k., për radion vendore private "Radio Durrësi", sipas licencës nr. 087/FML, në Rrethin Tiranë, në pikën transmetuese Fushë-Dajt, frekuenca 91.1 MHz.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati